



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
ZYRA VENDORE ARSIMORE TIRANË

Nr. 2517 Prot.

Tiranë, më 15.05.2020

URDHËR

Nr. 27 datë 15.05.2020

PËR

PARAQITJEN NË INSTITUCION DHE VIJUESHMËRINË E RREGULLT TË PUNËS SË MËSUESVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË ZVAP EMRIZYRES, QË ZHVILLOJNË PROCESIN MËSIMOR NË KLASAT EXII-TA SI DHE MËSUESVE TË TJERË TË AML, QË PËR NEVOJA TË PROCESIT MËSIMOR NJOFTOHEN PËR TU PARAQITUR NË INSTITUCIONIN ARSIMOR NË AFATIN KOHOR 18.05.2020-05.06.2020.

Bazuar në Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Ligjin Nr.7961 datë.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 13, datë 22.05.2019, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, Aktit Normativ të Këshillit të ministrave nr.3 datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative, gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, Urdhrin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar nr.45 datë 29.04.2020 “Për organizimin e mësimit , vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019-2020 për klasën e XII-të, shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar për krijimin e kushteve në institucionet arsimore për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020 për klasën e XII-të” drejtuar Zyrave Arsimore vartëse:

URDHËROJ

- 1.Marrjene e masave për paraqitjen dhe vijueshmërinë e rregullt të punës në institucionin arsimor për të gjithë mësuesit që zhvillojnë procesin mësimor në klasat e XII-ta të institucioneve arsimore si dhe mësuesve të tjerë, që për nevoja mësimore njoftohen nga drejtuesi i institucionit për paraqitje në institucionet e arsimit të mesëm të lartë të ZVAP Tiranë.
- 2.Punonjësit arsimorë sa më lartë, të respektojnë rigorozisht rregullat higjeno-sanitare dhe distancimin social gjatë paraqitjes dhe qëndrimit në institucionin arsimor.
- 3.Në rast të shkeljes së rregullave të përmendura më lart, për punonjësin përkatës do të zbatohen dispozitat përkatëse për marrjen e masave administrative sipas Ligjit Nr.7961 datë.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,dhe Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.
- 4.Në rastet e infektimit, apo të dyshimit të infektimit të punonjësit arsimor me COVID-19, të merren masat urgjente nga drejtuesi i institucionit arsimor të AML për mosparaqitjen e

mëtejshme të tij në institucion, vetëizolimën e punonjësit dhe familjarëve të tij në banesën përkatëse si dhe njoftimin e menjëhershëm të institucionit epror, ZVAP Tiranë dhe njësisë përkatëse të kujdesit shëndetësor.

5. Ngarkohen me zbatimin e këtij Urdhri drejtuesit e institucioneve arsimore të AML, punonjësit arsimorë që zhvillojnë mësimin në klasat e XII-ta të AML, si dhe punonjësit arsimorë të AML që për nevoja mësimore njoftohen nga drejtuesi i institucionit për paraqitje dhe kryerje detyrash në institucion.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR

Erjeta ALHYSA

